

M.Ü. İLÂHİYAT FAKÜLTESİ VAKFI YAYINLARI No: 439

İMÂM MÂTÜRÎDÎ
VE
TE'VÎLÂTÜ'L-KUR'ÂN

EDİTÖRLER

Prof. Dr. Hatice K. Arpaguş

Doç. Dr. Mehmet Ümit

Arş. Gör. Bilal Kır

1. Baskı



M.Ü. İLÂHİYAT FAKÜLTESİ VAKFI YAYINLARI No: 439

ISBN 978-975-548-485-3
T.C. Kültür ve Turizm Bakanlığı
Sertifika No: 16209

Kitabın Adı
İMÂM MÂTÜRİDÎ VE TE'VİLÂTÜ'L-KUR'ÂN

Editörler
Prof. Dr. Hatice K. Arpaguş
Doç. Dr. Mehmet Ümit
Arş. Gör. Bilal Kır

Sayfa Düzenlemesi
Hamit Sağlam

Kapak Tasarımı
Eren Sakız

Kapak Resmi
Şerbu't-Te'vilât, Süleymaniye Ktp., Esad Efendi, nr. 48

Baskı / Cilt: Pasifik Ofset
Cihangir Mah. Güvercin Cad. No: 3/1
Baha İş Merkezi A Blok Kat: 2
34310 Haramidere / İSTANBUL
Tel: 0212 412 17 77
Sertifika No: 44451

1. Baskı
Ekim 2019, İstanbul



İlahiyat Fakültesi



MARMARA ÜNİVERSİTESİ
İLÂHİYAT FAKÜLTESİ VAKFI
YAYINLARI



Ümraniye
Belediyesi

Uluslararası İmâm Mâtürîdî ve *Te'vilâtü'l-Kur'an* Sempozyumu M.Ü. İlahiyat Fakültesi ve Ümraniye Belediyesi işbirliği ile gerçekleştirilmiştir. Bu sempozyumda sunulan bildiriler üzerine inşa edilen metinler, kör hakem sürecinden geçerek kitap hâline getirilmiştir. Metinlerin muhteva ve dil bakımından sorumluluğu müelliflerine, teli hakları editörlere, basım organizasyonu ise anlaşmalı olarak M.Ü. İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları'na aittir. Yayınevinin izni olmaksızın, kitabın tümünün veya bir kısmının elektronik, mekanik ya da fotokopi yoluyla basımı, yayımı, çoğaltımı ve dağıtımı yapılamaz.

İsteme Adresi

M.Ü. İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları
Nuhkuyusu Cad. No: 110 Bağlarbaşı 34662 Üsküdar İSTANBUL
Tel: 0216 651 15 06 Faks: 0216 651 00 61
ifav@ilahiyatvakfi.com • www.ilahiyatvakfi.com

TEOLOGJIA E FEVE NË *TE'VILATIN* E IMAM MATURIDIUT

Metin IZETI*

PËRMBLEDHJE

Të kuptuarit e proceseve historike me ndryshimet dhe zhvillimet që shfaqen si realitete sociale, si dhe artikulimi i tyre në trajtë të medimit, përqëndrimit dhe rezultateve teologjike, është një rezultat i përkushtimit serioz të dijetarëve ndaj dijes dhe shpirtërisë. Një qasje të tillë e gjejmë në mendimin dhe sistemin e kelmistit dhe mufesirit të madh, Imam Maturidiut. Të gjitha veprat e tij, veçanërisht *Te'vilatu'l-Kur'an*, paraqesin figurën e thellë intelektuale dhe shpirtërore të tij. Ky artikull nuk do të merret me të gjitha etapat e teologjisë së feve në sistemin e Imam Maturidiut, por do të qëndrojë mbi modelin përfshirës (inkluziv) të konceptit të tij teologjik.

Duke pasur parasysh kohën kur u shkruajt *Te'vilati* i Imam Maturidiut si dhe teorinë e kohës së tij, mund të thuhet se ai është një komentim bashkëkohor i Kurani Kerimit. Për nga metoda dhe analizat, ajo është një vepër e aftë për të përcjellë dritë edhe në kohën tonë.

TEOLOGJIA E FEVE NË *TE'VILATIN* E IMAM MATURIDIUT

Ebu Mansur Muhammed b. Muhammed el-Maturidi (vd. 333/944) lindi dhe vdiq në fshatin Maturid të qytetit të famshëm të Semerkandit, në periudhën e Samanidëve në rajonin e Turkistanit dhe Transoksianës.¹ Me veprat e tij, Maturidiu nuk ka lënë gjurmë vetëm në Transoksiani dhe zonat përreth, por i ka bërë një shërbim të madh përhapjes së besimit të Ehli-Sunnetit, në mënyrë që bota islame të fitonte stabilitetin. Brenda mjedisit të mbushur me polemika ideologjike dhe politike, ai shmangu fanatizmin, tekfirin dhe përjashtimin dhe solli një rrugë të mesme në mënyrë që muslimanët të ishin të unifikuar në besimin dhe idetë e tyre. Këtë qasje e vërejmë në të gjitha veprat e tij. Gjëja që i ka dhënë famën dhe njohjen e tij si një prej dy imamëve të Ehli-Sunnetit është se në çështjet teologjike, ai nuk përdor vetëm metodën që gjendet në mendimin islam. Ai polemizon për çështjet teologjike

* Prof. Dr., Tetova Devlet Üniversitesi, Makedonya.

¹ el-Kureshî, *el-Cevâhiru'l-Mudîe fî Tabakâti'l-Hanefiyye*, III, 5; ez-Zebîdî, *Îthâfû's-Sâde el-Muttakîn bi Sherhi Esrârî İhjài Ulûmi'd-dîn*, II, 5; el-Leknevî, *el-Fevâidu'l-Behiyye fî Terâxhimi'l-Hanefiyye*, fq. 195.

të feve tjera duke sjellë argumente dhe metoda të reja, të cilat prodhojnë komentime të sistematizuara shumë më të forta. Si pasojë e mundit të sakrifikuar për zhvillimin e Ehli-Sunnetit, mbrojtjen e besimit Islam dhe ngjalljen e fesë, atij i janë dhënë llagape të ndryshme si *A'lâmu'l-hudâ*, *Îmâmu'l-hudâ* dhe *Îmâmu'l-mutekellimîn* etj.²

Maturidiu ka shkruar shumë vepra. Më të rëndësishmet prej tyre janë: 1. *Te'vilâtu'l-Kur'ân*; 2. *Kitâbu'l-Makâlât*; 3. *Kitâbu't-Tevhîd*; 4. *Kitâbu Meâhizi'ş-Şerâ'i fi Usûli'l-Fikh*; 5. *Kitâbu Bejâni Vehmi'l-Mu'tezile*; 6. *Kitâbu Reddi'l-Îmâme*; 7. *Kitâbu Reddi Usûli'l-Hamse*; 8. *Kitâbu Reddi Va'idi'l-Fussâk*; 9. *Kitâbu Reddi Evâili'l-Edille*.³

Midis shumë disiplinave mbi të cilat ka shkruar dhe ka punuar, në plan të parë qëndrojnë tematikat e kelamit dhe teologjisë. Ky terren ka qenë më i përshtatshmi për lëvrimin e mendimeve dhe ndërtimin e sistemit të tij. 'Te'vilati' i tij gjithashtu bën një komentim teologjik dhe kelamist të ajeteve Kuranore.

Imam Maturidiu është përpjekur ta zhvillojë sistemin e tij të mendimit në dy drejtime. Së pari, duke i vendosur përballë njëra-tjetrës parimet dhe problemet teologjike të Islamit dhe feve të tjera, ai është përpjekur të ofrojë një teologji të stërholluar nga aspekti intelektual dhe fetar.

Kështu, Imam Maturidiu ka studiuar me kujdes të gjitha devijimet teologjike të ardhura prej Ateizmit (*dehrijje*), politeizmit (*shirk*), dualizmit (*thenevijje*) dhe ehli-kitabëve dhe duke përdorur argumentet racionale dhe tradicionale, është përpjekur ta perfeksionojë konceptin e tevhidit Islam. Nga ana tjetër, ai ka treguar kujdes të veçantë për ta paqëtuar mendjen me tekstin pas tronditjes së pësuar nga racionalizmi rrënues i mutezilive. Kështu, Imam Maturidiu përmend në *Te'vilat* dhe *Kitâbu't-Tevhid* përkrah arsyes rendësinë që ka lajmi (*sem'ijjat*) dhe mësuesi.⁴

Të kuptuarit e proceseve historike me ndryshimet dhe zhvillimet që shfaqen si realitete sociale, si dhe artikulumit i tyre në trajtë të meditimit, përqëndrimit dhe rezultateve teologjike, është një rezultat i përkushtimit serioz të dijetarëve ndaj dijes

2 Hulejf, "Hyrje", *Kitâbu't-Tevhid*, fq. 1.

3 Më gjerësisht për jetën, veprat dhe mendimet e Maturidiut shih: en-Nese'fi, "Tebziratu'l-Edille", (e botuar me kritikën e Tanxhësë), fq. 8-9; el-Bejâzî, *Îshârâtu'l-Merâm an Îbârâti'l-Îmâm*, fq. 7; Ibn Kutluboğa, *Tâxhu't-Terâxhim fi Tabâkâti'l-Hanefijje*, fq. 59; Leknevî, *el-Fevâidu'l-Behijje fi Terâxhimi'l-Hanefijje*, fq. 195 dhe në vazhdim; ez-Ziriklî, *el-A'lâm Kâmusu't-Terâxhim*, VII, 242; el-Edimevî, *Tabakâtu'l-Mufessirîn*, fq. 34; Bilmen, *Büyük Tefsir Tarihi*, I, 376-78; en-Nese'fi, *Tabsiratu'l-Edille*, tah.: Hüseyin Atay, I, 471-473; Özdeş, *Mâtürîdî'nin Tefsir Anlayışı*, fq. 35-53; Kutlu, "Bilinen ve Bilinmeyen Yönleriyle İmam Mâtürîdî", fq. 18 dhe në vazhdim.; Kırca, "İmam Mâtürîdî'ye Göre Tefsir ve Te'vil Kavramları", fq. 156-171; Özen, "Mâtürîdî", fq. 146-159.

4 Këtë realitet, Imam Maturidiu e paraqet në mënyrën më të mirë në veprat e mëposhtme: *Kitâbu Bejâni Vehmi'l-Mu'tezile*; *Kitâbu Reddi'l-Îmâme*; *Kitâbu Reddi Usûli'l-Hamse*; *Kitâbu Reddi Va'idi'l-Fussâk*; *Kitâbu Reddi Evâili'l-Edille*, etj.

dhe shpirtërisë. Imam Maturidiu është një personalitet i tillë me përmasa universale. Gjatë kohës që sqaron ajetet që kanë të bëjnë me kristianët dhe jehudijtë në *Te'vilat*, ai paraqet teologjitë krishtere dhe jehude si dhe temat në të cilat muslimanët mund të bien në gabime. Ai parashtron idenë se fjala e Allahut mund të kuptohet nëpërmjet lirisë së komentit, shkathësisë arsyetuese dhe aftësive të tjera. Ai nuk ndalet vetëm në shtrimin e kësaj rruge për interpretuesit e tjerë, por e thekson se kjo është e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme. Për të kuptuar shpalljen dhe për aktualizimin e ideve të rëndësishme sipas tij, ai është i pari i dijetarëve të hershëm që mendon se, nevojitet një transformim i linjës së mendimit. Ai e ka shkruar tefsirin e tij me qëllim që të tregojë praktikisht se çfarë ka për qëllim kur flet për mënyrën sesi mund të bëhet një koment adekuat, duke mos ndenjtur në rrafshin teorik të çështjes.

Një mendim i tillë është lajmëtar i një ndryshimi paradigmatic në historinë e mendimit Islam. Për të shpjeguar parimet e temave të fesë Islame, Imam Maturidiu nuk është mjaftuar vetëm me rrethin e ngushtë të Islamit, por ka përdorur pa droje gjithashtu eksperiencën teologjike të feve të tjera. Ky qëndrim intelektual i Imam Maturidiut ka bërë që bota e krishterë ta konsiderojë si një prej mendimtarëve të parë të teologjisë së feve.⁵ Nëpërmjet teologjisë së feve, fetë trajtohen në rrafsh teologjik që të arrihet shkrirja në përjetimin fetar-intelektual. Ka pasur tentativa për të shpjeguar qëndrimet e tjera edhe para Imam Maturidiut, mirëpo ai u përpoq t'i analizonte me kujdes dhe të ndërtonte një sistem universal të mbështetur në eksperiencë. Kjo tentativë e tij ka sjellë në mendimin islam perspektiva të reja të mendimit. Ndryshe nga dijetarët e tjerë, Imam Maturidiu nuk e sjell çështjen vetëm për teologjinë e dijetarëve, por edhe për teologjinë e masave. Kjo bëhet më e qartë në *Te'vilat*.

Shpjegimin që u përpoqem ta sjellim pak më sipër, Imam Maturidiu e paraqet shkurtimisht në *Te'vilat* kur bën te'vilin e ajetit 34 të sures Nur:

﴿وَلَقَدْ أَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ آيَاتٍ مُّبِينَاتٍ وَمَثَلًا مِنَ الدِّينِ حَلُومًا مِّن قَبْلِكُمْ وَمَوْعِظَةً لِّلْمُتَّقِينَ﴾

“Ne u kemi shpallë juve argumente të qarta dhe shembuj nga ata që ishin para jush, e edhe këshillë për të ruajturit.”

Allahu Teala,-thotë Imam Maturidiu, nëpërmjet kësaj shprehjeje tregon se të vërtetën e përgjithësuar në ajetet Kuranore, ua ka zbritur të qartë dhe mbështetur në argumente. Midis tematikave që po shpjgohen janë gjërat të cilat janë të përshtatshme dhe të papërshtatshme për natyrën tuaj, si dhe ndërlidhja që ofron bota fizike drejt metafizikës apo Allahut, pra tregon se shënjesit e marrëdhënies ndërmjet jush janë të qartë dhe të thjeshtë. Këto shpjegime janë të vërtetat teologjike të fesë të cilat përfshijnë në vetvete argumentimin logjik për njëshmërinë e Allahut

5 Silajdzić, “Recepca drugih religija u klasičnim muslimanskim djelima”, fq. 73-93.

dhe vërtetësinë e shpalljes së pejgamberit. Kjo pjesë e ajetit përmban themelet teologjike të fesë islame të cilat i janë ngarkuar Pejgamberit dhe ndjekësve të tij. Në vazhdimin e ajetit *مَثَلًا مِّنَ الَّذِينَ خَلَوْا مِن قَبْلِكُمْ* tregohet se kjo e vërtetë i është qartësuar edhe pejgamberëve të mëparshëm dhe shoqërive të tjera fetare. Ai ju këshillon që duke e marrë në konsideratë shembullin e atyre që kanë qenë para jush, të analizoni elementët që ju afrojnë me Allahun dhe ato që ju largojnë prej tij.⁶

Në librin e tij *Kitâbu't-Tevhid*, Imam Maturidiu nëpërmjet një platforme filozofike i bën një shqyrtim të përgjithshëm të vërtetave teologjike të cilat gjenden në fetë e tjera, apo thënë në gjuhën bashkëkohore, teologjia e feve mbështetet në këtë platformë mendimi. Për shembull në teologjinë Kristiane kjo është një risi e paraqitur në shek. XX.⁷ Ky parim i vendosur prej Imam Maturidiut në veprat e tij, i ka ofruar muslimanëve një botë të gjerë mendimi mbi baza teologjike. Kjo perspektivë e re ia ka lehtësuar muslimanëve pranimin si realitet shoqëror të feve të tjera, duke mos i dhënë hapësira përplasjeve me baza ideologjike.

Ky qëndrim i Imam Maturidiut dhe ndjekësve të tij i ka njohur feve të tjera të drejtën e bashkëjetesës dhe e ka paraqitur dallimësinë me bazë teologjike si realitet të pamohueshëm. Prej punimeve që bëhen në ditët tona mbi dialogun ndër fetar, janë polemizuar parimet e kundërta, ka pasur përplasje intelektuale, mirëpo në sferën publike është mbrojtur dinjiteti i gjithësecilit. Sigurisht që për të arritur deri te kjo duhen njohur traditat e feve të tjera dhe duhen shmangur paragjykimet e regjura rreth tyre. Duke u nisur nga kjo, në trajtesat dhe mendimet e tij mbi teologjinë e feve, Imam Maturidiu mbështetet në njohuritë e mira që ka për fenë e tij si dhe në analizat që i bën burimeve formësuese dhe përmbajtëse të feve të tjera. Duke u nisur prej kësaj, ai paraqet realitetin social të teologjisë së feve të tjera, dallon në mënyrë të përgjithshme traditat fetare, qëllimet dhe rrugët e shpëtimit si dhe merret me saktësitë dhe problematikat intelektuale të tyre.

Kur bën komentimin e fillimit të sures Fatiha, Imam Maturidiu thotë se ka konsensus ndërmjet kelamistëve se kuptimi më i goditur i shprehjes 'zoti i botërave' është se 'fjala botëra përdoret për të emërtuar të gjitha krijesat dhe gjallesat në sipërfaqe të tokës'. 'Bota' është emri i çdo qenieje tjetër përveç Allahut. Në shprehjen Zoti i Botërave tregohet se sunduesi i të gjitha botëve është Allahu i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëpushtetshëm. Qoftë për ata që kanë kaluar, ata që janë apo ata që do të vijnë.⁸

6 Maturidi, *Te'vilatu'l-Kur'an*, X, 161.

7 Mendimtarët e krishterë nuk kanë studiar përmbajtjen e teologjisë islame si dhe bazën e tyre filozofike deri në shek. XX. Mund të kenë kërkime mbi fenë islame apo kulturën muslimane, fusha këto të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm sipas qëllimit përkatës, mirëpo asnjë studim nuk ka depërtuar në realitetet filozofike. Disa kanë përdorur parimet e teologjisë islame për të ndërtuar teologjinë e krishterë, mirëpo asnjëherë nuk e kanë përmendur burimin e tyre.

8 Maturidi, *Te'vilatu'l-Kur'an*, Fatiha, 1: 2.

Në ajetet e fundit të Fatihasë Imam Maturidiu bën një analizë teologjike kur thotë se:

﴿صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ﴾

“Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!”

Si pasojë e mirësisë së udhëzimit nga ana e Allahut, mbi çdo musliman që njehson Zotin ka begati të shumta. Fjala rrugë që përmendet vjen në kuptimin e fesë, sepse Allahu i ka begatuar me të mira të gjithë ata të cilët kanë jetuar duke njehsuar Zotin. Prandaj kuptimi këtu mund të merret në dy aspekte. E para, Allahu i ka begatuar ata sepse kanë qëndruar të rregullt në ndjekjen e librave dhe argumenteve logjike. Sipas këtij komentimi, rruga përbëhet prej Kuranit dhe argumenteve të tjera. E dyta, atyre që iu është shpalosur mirësia hyjnore janë ata që posedojnë ndonjë veçanti në aspektin fetar, nëpërmjet të cilës qëndrojnë mbi të gjithë besimtarët. Për shembull, shprehja e hz. Davudit dhe Sulejmanit:

“I falënderohemi vetëm All-llahut që na dalloi (me të mira) mbi shumë robër të Tij besimtarë.”⁹

Për sa i perket asaj se kush mund të jenë ata që meritojnë dënimin dhe janë të devijuar, Imam Maturidiu bën interpretime të ndryshme, në të njejtën kohë duke polemizuar mbi të gjitha dimensionet e temës në rolin e një teologu të krishterë apo jehudi. Disa dijetarë, thotë Maturidiu, i përkasin të dyja grupeve, sepse ata që devijojnë nga rruga e drejtë meritojnë zemërimin hyjnor, ndërsa të gjithë ata që meritojnë zemërimin cilësohen si të devijuar nga rruga e drejtë. Nëse analizojmë trajtën e shprehjes, kuptojmë se Imam Maturidiu, gjatë shprehjes së këtij mendimi, i shmanget dallimeve fetare duke e trajtuar çështjen në raportin ndërmjet njeriut dhe begative të Krijuesit. Nuk ka dyshim se qëllimi i Maturidiut është të tregojë se ky raport është i vërtetë në Islam, por gjithashtu tenton të thotë se kjo duhet të jetë mënyra sesi duhet të qasen edhe teologjitë e tjera.

Disa kanë thënë se ata që meritojnë zemërimin janë jehudijtë. Përmendja specifike e jehudijve me këtë cilësi të keqe në krahasim me idenë se e vërteta është e paarritshme në krishtërim, ka ndodhur si pasojë e këmbënguljes kryeneçe dhe mendjemadhësisë. Pikërisht prej këtyre shprehjeve Imam Maturidiu i sjell ballë për ballë teologjitë judeo-krishtere dhe i analizon. Për shembull, thotë Maturidiu, mohimi i profecisë së hz. Isait, tentativa për ta vvarë, -të cilat nuk janë shfaqur te të krishterët, pastaj thënia se “dora e Allahut është e shtrënguar”¹⁰ janë si pasojë e urrejtjes së tyre. Këta kanë shpresuar që prej tyre do të dalë një profet i cili do t'i

9 Neml, 27:15.

10 Maide, 5: 64.

ndihmojë kundër idhujtarëve, mirëpo pavarësisht kësaj me ardhjen e Pejgamberit a.s refuzuan besimin dhe nisën të shfaqin shenja të kryeneçësisë dhe hipokrizisë; pra, si pasojë e këtyre karakteristikave të devijuara dhe të tjerave të ngjashme me to, janë meritore specifike për zemërimin hyjnor.¹¹

Imam Maturidiu në shpjegimet e sures Ihlas bën teologji feje pozitive. Ai thotë kështu:

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ﴿1﴾ اللَّهُ الصَّمَدُ ﴿2﴾ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ﴿3﴾ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ﴿4﴾﴾

“*Thuaj Allahu është një*”, Imam Maturidiu thotë se transmetohet se kur Pejgamberi a.s po ftonte për në besim, populli i Mekkes e pyetën për prejardhjen e Allahut, ndërsa në një transmetim tjetër e pyetën për trajtën apo për natyrën e Allahut, pyetje të cilat shkaktuan zbritjen e sures Ihlas. Nëpërmjet saj u mësua çdo përgjigje e pyetjeve të cilat vinin rreth Allahut. Ajo sure përmban përgjigje të shkurtra dhe thjeshta për çdo person i cili ka pyetje të ngjashme.

Forma përfundimtare e qëndrimit tonë, thotë Imam Maturidiu, është se: Allahu është në Qenien e vet Krijues, i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë që në ezal. Krahas kësaj, çdo qenie që e ka arritur mëshira dhe që ka manifestuar në vetvete pushtetin dhe kontrollin hyjnor, ka fituar mundësinë për të qenë... Sipas nesh, ajo që është me rëndësi është se çdo koncept me të cilin cilësohet Allahu ka të bëjë me Qenien (*Dhat*) e tij, sepse është e pamundur që Ai të pësojë ndryshim, tjetërsim apo të arrijë Lavdinë nëpërmjet diçkaje që është krijuar me kohën... Sipas nesh, ajo që është thelbësore është se Allahu ia ka ndaluar çdokujt begatinë dhe nderin për tu quajtur Zot, me përjashtim të disa rasteve të veçanta të shfaqura kohë pas kohe. Emri i përdorur si cilësues në këto raste bart kuptimin origjinal të tij duke iu mveshur dikujt tjetër. Arsyeja e kësaj nuk është se ai person posedon natyrë mbi-krijese, por supozohet se ky është mjet për të ecur dhe për tu afruar me Allahun...

Qasje të tilla mund të gjenden në të gjitha veprat e Imam Maturidiut. Në këtë punim modest u paraqit teologjia e feve që Imam Maturidiu bën duke trajtuar fetë e kohës së tij me një analizë të gjerë shumëdimensionale, si dhe u përmend potenciali që vepra e tij ka për të kontribuar në punimet bashkëkohore.

BIBLIOGRAFIA

el-BEJÂZÎ, Kemâluddîn Ahmed, *İshârâtu'l-Merâm an İbârâti'l-İmâm*, Stamboll: 1979.

BILMEN, Ö. Nasuhi, *Büyük Tefsir Tarihi*, Stamboll: Sh.B. Bilmen, 1973.

el-EDIRNEVÎ, Ahmed b. Muhammed, *Tabakâtu'l-Mufessirîn*, tah.: M. Özel – M. Erbaş, İzmir: 2005.

HULEJF, Fethullah, “Hyrje”, *Kitâbu't-Tevhid*, tah.: Fethullah Hulejf, Stamboll: 1979.

IBN KUTLUBOĞA, Kâsım, *Tâxhu't-Terâxhim fi Tabâkâti'l-Hanefijje*, Bagdat: 1962.

¹¹ Maturidi, *Te'vilatu'l-Kur'an*, Fatiha, 1: 7.

- KIRCA, Celal, "İmam Mâtürîdî'ye Göre Tefsir ve Te'vîl Kavramları", *Kur'an ve Bilim*, Stamboll: 1996, fq. 156-171.
- el-KURESHÎ, Abdu'l-Kadîr b. Ebi'l-Vefâ Muhammed, *el-Cevâhiru'l-Mudie fi Tabakâti'l-Hanefiye*, Egipt: pa datë.
- KUTLU, Sonmez, "Bilinen ve Bilinmeyen Yönleriyle İmam Mâtürîdî", *İmam Mâtürîdî ve Maturidilik*, përgatiti: S. Kutlu, Ankara: SH. B. Kitabiyat, 2003.
- el-LEKNEVÎ, Muhammed Abdulhâjj, *el-Fevâidu'l-Behiye fi Terâxhimi'l-Hanefiye*, Bejrut: pa datë.
- el-MATURIDI, Ebu Mansur, *Te'vilatu'l-Kur'an*, Stamboll: Sh. B. Mizan, 2005-2011, I-XVII.
- en-NESEFÎ, Mejmun b. Muhammed Ebu'l-Muîn, "Tebziratu'l-Edille", e botuar me kritikën e Tanxhësë, revista e fak. Teologjik, 1-2 (Ankara: 1955): 8-9.
- en-NESEFÎ, Mejmun b. Muhammed Ebu'l-Muîn, *Tabziratu'l-Edille*, tah.: Hüseyin Atay, Ankara: 1993.
- ÖZDEŞ, Talip, *Mâtürîdî'nin Tefsir Anlayışı*, Stamboll: İnsan Yayınları, 2003.
- ÖZEN, Şükrü, "Mâtürîdî", *DİA*, Stamboll: 2003, XXVIII, 146-159.
- SILAJDŽIĆ, Adnan, "Recepçija drugih religija u klasičnim muslimanskim djelima", *Zbornik Fakulteta islamskih nauka u Sarajevu (7/2001.)*: 73-93.
- ez-ZEBÎDÎ, es-Sejjid Murtezâ M. b. Muhammed el-Husejñî, *İthâfu's-Sâde el-Muttakîn bi Sherhi Esrârı İhjai Ulûmi'd-dîn*, Kairo: pa datë.
- ez-ZIRİKLÎ, Hajrudîn, *el-A'lâm Kâmusu't-Terâxhim*, Bejrut: 1984.

ÖZET

İMÂM MÂTÜRÎDÎ'NİN TE'VİLÂT'INDA DİNLERİN TEOLOJİSİ

Tarihî süreçleri anlamak ve o süreçler işleyişinde toplumsal realite içerisinde ortaya çıkan değişim ve gelişmeleri, teolojik müşahede, somutlaşma ve hüküm çıkarma önermeleri olarak şekillendirebilmek ciddi ve ilm-ü irfâna kendini adayan âlimlerin harcıdır. Bu şekildeki bir yaklaşımı üstün bir kelâmcı ve müfessir olan İmâm Mâtürîdî'nin düşünce ve hareket sisteminde görmektediriz. Onun tüm eserleri, özellikle de *Te'vilâtü'l-Kur'an*'ı derin entelektüel ve manevî figürünü açıkça ortaya koymaktadır. Bu makale İmâm Mâtürîdî'nin sisteminde dinler teolojisinin tüm etapları ele alınmasa da, onun teolojik anlayışındaki ihtivacı (*inklusivist*) modeli üzerinde durmaktadır.

İmâm Mâtürîdî'nin *Te'vilât*'ı yazıldığı döneme kadarki ve dönemindeki nazariyeleri göz önüne alarak, dönemi açısından, çağdaş düşünceye (dirâyet) dayanan bir Kur'an-ı Kerim yorumudur. Metodolojisi ve analizleri açısından dönemimize de ışık tutabilecek nitelikte bir eserdir.